



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHIJAK
DREJTORIA EKONOMIKE**

DATE 10/03/2020

RELACION

“MONITORIMI I BUXHETIT PËR PERIUDHËN

JANAR – DHJETOR 2019 “

Realizimi i buxhetit të vitit 2019 është bërë duke u mbështetur në Ligjin 57/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në Ligjin 68 datë 24/04/2017 “Për financat e veteqeverisjes vendore”, Ligjin 139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” në Ligjin nr 99/2018 “Për Buxhetin e Shtetit të Vitit 2019.”, në Udhezimin nr 9 të Ministrisë së Financave datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”, të Udhezimit plotësues nr 1 datë 17.01.2019 “Për Zbatimin e Buxhetit të vitit 2019”, në Udhezimin nr 7 datë 27/02/2019 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afat Mesëm Vendor 2020-2022” në Udhezimin nr 26 datë 27.09.2019 “Procedura për Menaxhimin e vështiresive financiare për njësitë e qeverisjes vendore”, në ligjin nr 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, si dhe në VKB nr 27 datë 25.11.2019 mbi “Miratimin e Paketës Fiskale për vitin 2020” VKB nr.68 dt 20.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2019 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm Përfundimtar 2020-20201 të Bashkisë Shijak”

Programi Buxhetor Afatmesëm parashikon një mbulim sa më të plotë të territorit me shërbime publike

cilësore me qëllim përmirësimin e jetesës së qytetarëve; përmirësimin dhe modernizimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe asaj rurale, përmirësimin e shërbimit të pastrimit në të gjithë territorin, rritjen e sipërfaqeve të gjelbërta; përmirësimin e infrastrukturës turistike dhe aksesit; mbështetjen e iniciativave për zhvillimin e zonave të përmirësimit të biznesit; nxitjen e investimeve në

kërkim; mbrojtjen e tokave bujqësore, rehabilitimin dhe investimin e infrastrukturës bujqësore, promovimin dhe marketingun e produkteve bujqësore; mbrojtjen e mjedisit, ruajtjen dhe përmirësimin e tij; zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive; sigurimin e mbrojtjes civile dhe menaxhimin e katastrofave në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak;

Zbatimi i Programit Buxhetor Afatmesëm 2019-2021 është një instrument i rëndësishëm për përmirësimin e cilësisë së jetës, përmirësimin e aksesit, integrimin territorial dhe barazinë në shërbime, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, rritjen e cilësisë së jetesës, dhe mbrotjen e mjedisit duke e kthyer Shijakun në një qendër të përparuar social - ekonomike. Ky dokument ka përcaktuar 21 programe dhe një seri funksionesh dhe aktiviteteve respektive për çdo funksion, prandaj është treguesi më i mirë se si shpenzimet e planifikuara lidhen me veprimtaritë dhe projektet e planifikuara si dhe me Strategjinë e Zhvillimit dhe Planet Vendore që i mbështesin këto projekte.

TE ARDHURAT LOKALE TE BASHKISE SHIJAK PER VITIN 2019

Në tabelën e mëposhtëme pasqyrohet realizimi i të ardhurave për çdo zë më vete për Bashkinë Shijak :

NR	EMERTIMI	Plani 12 Mujor	Fakti 12 Mujor	Diferenca ne Lek	Diferenca ne %
A.	TE ARDHURA TATIMORE	161,373	130,292	31,081	81%
I	Taksa mbi Pasurine e Paluajtshme	69,552	46,395	23,157	67%
a.	Taksa mbi Ndertesen	47,716	45,045.	2,671	94%
	Biznesi	30,858	35,017.	(4,159)	113%
	Popullsia	16,858	10,028.	6,830	59%
b.	Taksa mbi Token Bujqesore	21,836	6,199.	15,637	28%
II	Taksa Vendore Biznesi I Vogel	6,300	2,521.	3,779	40%
III	Te ardhura te tjera vendore	70,631	61,002	9,629	86%
b.	Taksa e Ndikimit ne Infrase per Ndertesat e reja	65,549	38,106.	27,443	58%
c.	Taksa e Truallit	5,082	5,408.	(326)	106%
IV	Taksa te administruara nga agjente tatimore	11,690	16,137	(4,447)	138%
a.	Taksa per Kalimin e Pasurise se Paluajtshme	1,400	4,652.	(3,252)	332%
b.	Taksa e mjeteve te perdoruara	10,290	11,485	(1,195)	112%
V	Taksa e Tabeles	3,200	4,177	(977)	131%

a.	per qellime identifikimi	200	60.	140	30%
b.	per qellime Reklamimi	3,000	4,117.	(1,117)	137%
B.	TE ARDHURA JOTATIMORE	45,202	25,462	19,740	56%
I	Te ardhurat nga tarifat	45,202	25,462	19,740	56%
1	Tarife e Pastrimit dhe e Gjelberimit	28,946	13,302	15,644	46%
	Biznesi	15,440	10,704.	4,736	69%
	Popullsia	13,506	2,598.	10,908	19%
2	Tarife e Ndrimit	2,336	960	1,376	41%
	Biznesi	1,040	707	333	68%
	Popullsia	1,296	253.	1,043	20%
4	Tarifa per Sherbime Veterinare	-	-	-	-
5	Tarifa e Sherbimit te transportit	3,000	2,660.	340	89%
6	Tarifa e Parkimit	50	12.	(38)	24%
7	Tarifa per vertetime, autorizimeetj	600	473.	-127	79%
8	Tarifa te sekt te bujqesise e pyjeve	1,000	1,231.	(231)	123%
9	Tarife sherbimi nga instit arsim kulture sport	210	131.	79	62%
10	Tarife per sherbime MKZ	500	872	(372)	174%
11	Tarifa e tregutte lire	530	501	29	95%
12	Tarife per zenie hapsire publike	30		30	0%
15	Tarifa e drejtorise kont dhe zhvill teritorit	8,000	16,879	8879	211%
				-	
C.	TE ARDHURA TE TJERA	12,355	10190	2165	82%
I	Te ardhura nga institucionet	1,800	1,215	585	68%
a.	Te Ardhura Kopeshte Cerdhe	1,800	1,215	585	68%
II	Te ardhura te tjera	10,555	8975	1580	85%
1	Detyrime te pambledhura 2018	10,000	6,071	3,929	61%

2	Gjoha nga mos shlyerja ne afat e detyrimeve	55	137	(82)	249%
3	Gjoha per shkeljet administrative	500	2767	(2267)	553%
	TOTALI	218,930	164,804	54,126	75%

Sic shihet nga tabela Realizimi i të Ardhurave në Total per vitin 2019 është në masën 75%. dhe ne vlere – 54.126 mije leke

Në territorin e Bashkisë Shijak për vitin 2019 ushtruan aktivitet 833 subjekte nga të cilat 220 subjekte Biznes i Madh dhe 613 subjekte biznes i vogël.

Kanë shlyer detyrimet 576 subjekte nga të cilat 152 biznesi i madh dhe 424 biznesi i vogël.

Të ndarë sipas njësisive administrative nr. i bizneseve paraqitet në tabelën e mëposhtëme:

		Nj.A.Shij	Nj.A.Xhafz	Nj.A.Mamin	Nj.A.Gjep	Gjithsej
1	Biznesi i Madh	36	146	35	3	220
	Paguar	29	99	24	0	152
	Papaguar	7	47	11	3	68
2	Biznesi i vogel	215	279	93	26	613
	Paguar	168	182	63	11	424
	Papaguar	47	97	30	15	189


Gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2019 kanë pezulluar aktivitetin 67 subjekte nga të cilat 13 subjekte biznesi i madh dhe 54 subjekte biznesi i vogel.

1.Taksa mbi Ndërtesën : Planifikimi i taksës së ndërtesës për periudhën Janar – Dhjetor ka qenë në total 47.716; ku ndahej në dy pjesë :

Burimi i te Ardhures	Taksë mbi Ndërtesën			Viti 2019	
	Fakti 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Biznesi	37,456	30,858	35,017	113	+4,159
Popullsia	3,385	16,858	10,028	59	-,6,830
Totali	40,841	47,716	45,045	94	- 2,671

Sic shihet nga tabela realizimi i biznesit ne masen 113 % se ne shumen + 4159 mije leke perfshin edhe likujdime te bizneseve per detyrime te prapambetura dhe kjo shkon ne masen e 5.000 lekeve gje qe do te thote qe duke e zhveshur kete realizim per kete shume kemi realizimin e kesaj takse ne 97 % nga biznesi, nderkohe ka vazhduar puna per sistemimin dhe saktesimin e siperfaqeve te ndertesave , per te korrigjuar dhe per te shkuar ne nje planifikim sa me real.

Popullsia ka nje realizim ne masen 59 % duke krijuar nje deficit ne te ardhura per shumen 6830 mije leke. Shume e veshtire menyra e mbledhjes se detyrimeve te popullsisë per te gjitha llojet e taksave apo tarifave vendore.




Sektori I taksave po punon për përmirsimin e bazës së të dhënave mbi ndërtesat mbështetur në metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të

pasurise së paluajtshme “Ndërtesa”.Sektori I taksave bën çdo muaj rakordimin e të ardhurave nga taksa e ndërteses me 3 - Njësitë Administrative.

2. Taksa mbi Tokën Buqësore :

Burimi i te Ardhures	Taksa mbi Tokën Buqësore			Viti 2019	
	Fakti 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totali	8,728	21,836	6,199	28	-15,637

Realizimi i të ardhurave nga kjo taksë është në masën 28 %.Taksa mblidhet nga inspektorët e taksave pranë njësive administrative Xhafzotaj ,Maminas,Gjepale. Ka vështirësi në mbledhjen e taksës së tokës buqësore për shkak të aftësisë së pakët paguese që kanë banorët e fshatrave të njësive administrative.Sektori I taksave bën cdo muaj rakordimin e të ardhurave nga taksa e tokës buqësore me njësitë administrative .



3. Taksa Vendore Biznesi i Vogel :

Burimi i te Ardhures	Taksa Vendore Biznesi i Vogel			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca

Totali	5.157	6.300	2,521	40	- 3.779
--------	-------	-------	-------	----	---------


Realizimi i të ardhurave nga ky zë shkon në masën 40%.

Agjenti tatimor për mbledhjen e taksës vendore të biznesit të vogël është Drejtoria e Tatim Taksave Durrës. Sektori i taksave bën çdo muaj rakordimin me këtë drejtori lidhur me të ardhurat e gjeneruara nga kjo taksë.

4. Taksa e ndikimit në Infrastrukturë :

Realizimi i të ardhurave nga taksa e Infrastrukturës shkon në masën 58%.


Burimi i te Ardhures	Taksa e ndikimit në Infrastrukturë			Viti 2019	Diferenca
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	
Totali	41.286	65,549	38.106	58	-27.443



Taksa e ndikimit në infrastrukturë mbledhet nga Drejtoria e Urbanistikës në momentin e aplikimit për leje. Planifikimi i të ardhurave nga kjo taksë është bërë duke marrë parasysh realizimin e të ardhurave nga taksa të vitit paraardhës.

5. Taksa e truallit :

Burimi i te Ardhures	Taksa e truallit			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totale	3.907	5,082	5.408	106	+326




Të ardhurat e taksës së truallit shkon në masën 106%.

Të dhenat për trojet janë në permiresim të përditshëm pasi kjo takse u fut për herë të parë në vitin 2017 me ligj ,pasi nuk kemi të dhëna nga ZRPP Durrës megjithë kërkesat tona drejtuar këtij institucioni ,kështu edhe planifikimi është bërë në mënyrë të përafërt.

6.Taksa e Regjistrimit të Përvitshëm të Mjeteve të Përdorura :

Realizimi i kësaj të ardhure është 112%.

Burimi i te Ardhures	Taksa e Regjistrimit të Përvitshëm të Mjeteve të Përdorura			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totale	10.552	10.290	11.485	112	1,195




Agjenti tatimor për mbjedhjen e taksës së mjeteve të përdorura është DRSHAP Durres. Sektori i taksave bën rakordime periodike me këte drejtori për sa i përket të ardhurave të mbledhura nga kjo taksë.

7. Taksa e tabelës : Të ardhurat nga kjo taksë paraqiten si më poshtë:

Realizimi i të ardhurave nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi shkon në masën 131 %. Tabela për qëllime reklamimi dhe identifikimi:


Burimi i te Ardhures	<u>Taksa e tabelës</u>			Viti 2019	
	Fakti/2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totali	3,673	3,200	4,177	131	977



8. Tarifa e Pastrimit dhe e Gjelbërimit : Realizimi i tarifës së pastrimit dhe gjelbërimit ka qenë në total 113.302 leke; dhe perbehet :

Burimi i te Ardhures	<u>Tarifa e Pastrimit dhe e Gjelbërimit</u>			Viti 2019	
	Fakti/2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Biznesi	10,530	15,440	10,704	69	-4,736
Popullsia	4,022	13,506	2,598	19	-10,908
Totali	14,552	28,946	13,302	46	-15,644

E shprehur në përqindje totali realizimit i tarifës së pastrimit dhe gjelbërimit (Biznes + Popullsia) është në masën 46%, ku 69 % e përbën Biznesi dhe 19% Popullsia. Sic shihet nga të dhënat e mësipërme në nivel më të ulët mosrealizimi I kësaj tarife vjen nga popullsia, kjo si rezultat I faktorëve social dhe ekonomike. Nga ana e sektorit të taksave janë dërguar njoftim detyrimet për cdo familje. Në përmirësimin e mbledhjes së të ardhurave nga tarifa e pastrimit dhe ndricimit do të ndikojë futja e detyrimeve në faturen e ujit ,në momentin e kalimit të ujesjellës kanalizime në administrimin e bashkisë. Paraqitja grafikesi mëposhtë:




9. Tarifa e Ndrimit: Realizimi i tarifës së ndricimit ka qenë në total 960 mije leke ku perbehet në dy pjesë :

E shprehur në përqindje në total realizimi i të ardhurave nga Tarifa e Ndrimit (Biznes + Popullsia) është në masën 41 %, ku 68% e përbën Biznesi dhe 20% Popullsia.

Burimi i te Ardhures	<u>Tarifa e Ndrimit</u>			Viti 2019	
	Fakti 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Biznesi	741	1,040	707	68	333
Popullsia	402	1,296	253	20	1,043

Totali	1,144	2,336	960	41	1,376
--------	-------	-------	-----	----	-------



10. Tarifa e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit :

Realizimi i të ardhurave nga Tarifat e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit shkon në masën 67%. Këto tarifa paguhen në momentin e marrjes së lejeve të ndryshme nga Sektori i Urbanistikës. Planifikimi i këtyre tarifave bëhet duke marrë parasysh realizimin e vitit paraardhës dhe aplikimet për leje të ndryshme.

Burimi i te Ardhures	<u>Tarifa e Drejtorisë së Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit</u>			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totali	8,650	8,000	16,879	211	8,879

12. Tarifa për Dhënie Leje Transporti:

Burimi i te Ardhures	<u>Tarifa për Dhënie Leje Transporti</u>			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totali	2,894	3,000	2,660	89	-340

Realizimi i të ardhurave nga tarifa e lejeve të transportit shkon në masën 89%.

Tarifa për dhënien e lejeve të transportit lëshohet nga Sektori I Shërbimeve. Planifikimi i këtyre tarifave bëhet duke marrë parasysh realizimin e vitit paraardhës dhe aplikimet për leje të ndryshme.

15. Të ardhurat nga Kopeshti + Cerdhja :

Realizimi i të ardhurave nga tarifat e Kopeshtit + Cerdhes janë 67 %.

Burimi i te Ardhures	<u>Të ardhurat nga Kopeshti + Cerdhja</u>			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca
Totali	1,317	1,800	1,215	68	-585


Realizimi i ketij zeri varet nga pjesëmarrja e femijeve ne kopeshte e cerdhe dhe nga afati i likujdimit te detyrimeve sipas kosos se ushqimit. Zakonisht likujdimi behet ne menyre te rregullt nga prinderit e femijeve, dhe detyrim ngelet vetem muaji i fundvitit i cili paguhet ne janar te vitit pasardhes.

16. Tarifë për Shërbime MZSH :

Realizimi i të ardhurave nga Tarifat për Shërbimin e MZSH janë në masën 174%. Këto tarifa administrohen nga Sektori i MZSH, hde tregon punen e mire qe eshte bere ne kete sektor per paisjen e bizneseve me detyrimet ligjore qe kane lidhje me kete sherbim.

Burimi i te Ardhures	<u>Tarifë për Shërbime MZSH</u>			Viti 2019	
	Fakti/ 2018	Plan	Fakt	% Realizimit	Diferenca

Totali	857	500	872	174	+372
--------	-----	-----	-----	-----	------



Produktet për vitin 2019

Aktivitetet dhe projektet që u realizuan për v.2019 janë:

Ndërtim i Administratës së Bashkisë së Shijak në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë së Shijak për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve.

Kemi synuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të Administratës së Bashkisë Shijak përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Mbështetje e strukturës funksionale me 185 punonjës me kohe te plote dhe 10 punonjës me kohe te pjeseshme. Plotësim sipas nevojës dhe rekrutimi i personelit të administratës vendore në mënyrë transparente, me profesionalizëm dhe në bazë të meritave, aftësi profesionale, pavarësisë dhe integritetit, vazhdimësisë së karrierës, përgjegjësisë dhe korrektesës dhe në zbatimin e ligjeve:

Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar. Paga, shtesat mbi pagat e punonjësve bëhen sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.165 datë 02.03.2016 "Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, VKM nr. 717, date 23.6.2009, të Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve buxhetore" të ndryshuar; Numri i aplikuesve për vendet e shpallura ishte rreth 11 aplikues.

Këto rekrutime janë realizuar me procedurën e 2 lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë 3 për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në 11 shërbimin civil për kategorinë

ekzekutive. Kjo procedurë është realizuar përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive". Konkurrimi ka ndjekur disa etapa, përfshirë ngritjen e Komisioneve të pranimit. Anëtarë të komisioneve të vlerësimit gjatë procesit të rekrutimit kanë qenë punonjës të nivelit drejtues të administratës publike vendore si dhe ekspertë jashtë institucionit të Bashkisë Shijak. Realizuar 11 procedura në kategorinë ekzekutive me nga dy eksperte të jashtëm.

Trajnimi i burimeve njerëzore të Bashkisë së Shijak

Ky aktivitet synonte që nëpunësit civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë të mund të kryenin trajnime në institucione të tjera trajnuese me inisiativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2019 janë zhvilluar 59 për trajnime për 113 punonjës si: trajnime të vijueshme profesionale të audituesve të brendshëm, trajnim të punonjësve të sapo rekrutuar për detyrat dhe përgjegjësitë e pozicioneve të punës, për realizimin e objektivave të drejtorive përkatëse etj. Këto trajnime janë realizuar me mbështetjen e Bashkisë Shijak dhe të donatorëve, organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin e administratës së Bashkisë është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë së Shijak nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim telefonie, interneti etj.

Shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën e Bashkisë së është mundësuar sigurimi dhe furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën.

Shërbime mbështetëse bazë të mirëmbajtjes (materiale elektrike, dhe paisje të tjera shtesë) Gjatë vitit 2019 janë realizuar blerja e materialeve, elektrike dhe bojera, stuko etj për lyerje.

Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë së Shijak . Është realizuar furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë nevojave në qendër , njësi administrative etj . U realizua shërbimi i riparimit për të gjitha automjetet,shlyerja e të gjitha sigurimeve, taksave të qarkullimit dhe kolauditimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës .

Blerje pajisje zyre për administratën e Bashkisë së Shijak

Pajisje me Uniforma për Policinë Bashkiake

Është realizuar pajisja me uniforma për Policinë Bashkiake për vitin 2019, bazuar në ligjin 8224 ,date 15.05.1997 "Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe të komunës, i ndryshuar dhe VKM nr. 333 datë 02.06.1998 për "Miratimin e normës së veshmbathjes për policinë", i ndryshuar, dhe urdherat në zbatim të këtij ligji ku përcaktohen qartë standartet dhe

kriteret për normat e uniformave të policisë bashkiake. Gjithashtu ne mbeshtetje për kryerjen e funksionit të policisë u është siguruar furnizimi me karburant dhe mirembajtje për mjetin e tyre.

Blerje pajisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)

Dita ndërkombëtare e fëmijëve, 1 Qeshori

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve është realizuar aktiviteti në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve, shkollat 9 vjecare dhe organizatat partnere të shoqërisë civile ka organizuar aktivitetin social, kulturor, sensibilizues me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve. Ky aktivitet u organizua në Pallatin e cultures “Qazim Domi” pjesëmarrës rreth 240 fëmijë.

Administrimi dhe funksionimi i Çerdheve.

Është realizuar vlerësimi i nevojave për ndërhyrje me qëllim krijimin e kushteve sa më të favorshme për foshnjat që frekuentojnë çerdhe duke sistemuar femijet e kësaj kategorie në një ndertese të re të ndertuar nga donator. Numri i femijeve që frekuentojnë këte çerdhe është 28, ndersa numri i femijeve që frekuentojnë kopeshtin me dreke është 70.

Gjate 2018 Këshilli Artistiko Kulturor i Bashkisë Shijak i përbërë prej 3 anëtarësh funksionoi rregullisht. Ai mori në shqyrtim në bazë të një procedurë të parashikuar në ligj, të gjithë projektet kulturore, artistike, rinore dhe sportive të Bashkisë Shijak të reflektuar në 9 mbledhjet e tij vjetore.

Pjesë e programit për rininë dhe sportet ka qenë organizimi i përvitshëm i aktiviteteve sportive dhe zhvillimi i sportit në komunitet. Nepermjet programit për rininë dhe sportin mbështeten administrimi dhe funksionimi i Klubit Volejbollit “Erzeni” dhe Klubi i futbollit “Erzeni”

Emergjencat Civile kanë qenë në gadishmeri të plote gjatë vitin, për të përballuar me se miri ngjarjet e rënda si termeti i datës 26 Nëntor të vitit 2019, që ishte një sprovë e madhe për administratën e Bashkisë të cilën e përballuam dhe vazhdojmë të përmballojmë ngarkesën e madhe të punëve që lindin nga ajo emergjence. Kanë patur suport të vazhdueshëm në mjete, burime njerëzore dhe karburant.

Shërbimi i MZSH ka patur prioritet parandalimin e ngjarjeve. Është rritur numri dhe llojet e shërbimeve të sektorit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, por struktura e ofrimit të shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi duhet të jetë në përputhje me standartet e kerkuara me ligj.

Programi i Menaxhimit të Territorit mbulon gjithë territorin administrativ të bashkisë me të gjitha llojet dhe karakteret e territorit si ajo urban, rural, bujqësor, natyror apo sipërfaqe ujore.

Gjatë vitit 2019 kanë përfunduar projekte të ndryshme të Rikonstruksioneve të rrugëve urbane dhe rurale

- Ka përfunduar likuidimi I “Rrjeti Rrugor Qyteti Shijak” me fonde të FSHZH
- Ka përfunduar likuidimi I “Rruga 8 Marsi dhe degezimet” me fonde të FSHZH detyrim I vitit 2013
- Ka përfunduar likuidimi objektit “Rikualifikim i Kuartalles” me fondet e bashkisë

Gjithashtu për një shërbim sa më të mirë të qytetarëve të Bashkisë Shijak nepermjet mirembajtjes dhe krijimit të infrastructures në KUZ kemi si më poshte:


- Ndertimi I Kanalit I Ujerave të Zeza në fshatin Sallmone të Nj.Ad Xhafzotaj(vazhdon)
- Rehabilitimi I Hapësirave Rekreative (Parku)në ish shkollën M Dollaku .(vazhdon)

Realizimi I Shpenzimeve sipas Programeve per vitin 2019

Emri i Grupit							Kodi i Grupit	
Programet	Shpenzi met e Njesisë së Vetëqeve risjes Vendore							
	(1)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)		
	Fakti	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca		
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhës Viti 2018	Plan Fillestar Viti 2019	Plan i Rishikuar Viti 2019	Plani i Periudhes/p rogresiv	i Periudhes/ progresiv	Realiz ne %	
011	Org ekzek dhe legjis, Ceshjtjet financ	90,207	74,142	10,173	84,315	79,721	(4,594)	95
013	Sherbime te pergjith auditi + gj.civ	7,492	7,735	1,464	9,199	8,257	(942)	90
031	Sherbime e Policise	12,465	7,410	1,009	8,419	7,676	(743)	91
032	Sherbimet e mbrojtjes nga zjarri	16,118	12,393		12,393	10,919	(1,474)	88
041	Ceshjtjet e pergjith ekon, treg punes	4,944	4,688		4,688	3,969	(719)	85
042	Bujqesia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia	38,174	28,958	28,639	57,197	51,167	(6,430)	89
045	Trasp dhe miremb rruges+ fzhr	128,593	399,567	24,020	49,799	42,745	(7,054)	86
051	Menaxhimi I mbetjeve	28,296	40,743	13,377	54,120	43,236	(10,884)	80
052	Menaxhimi I ujerave te zeza		25,800		25,800	4,400	(21,400)	17
053	Reduktimi I ndotjes		500		500		(500)	-
061	Planif Urban Vendor		9,300		9,300	8,070	(1,230)	87
062	Sherbimet publike vendore	75,298	32,201	659	32,860	13,324	(19,536)	41
063	Furnizimi me uje	13,684	1,500	630	2,130	1,730	(400)	81
064	Ndricimi I rrugeve		22,029	4,000	14,614	10,560	(4,054)	72
081	Sherbimet Rekreative dhe sportive	30,620	28,307	4,500	32,807	26,822	(5,985)	82
082	Sherbime kulturre	2,659	4,286	162	3,237	2,939	(298)	91

091	Arsimi baze dhe parashkollor	91,740	74,624	63,444	138,068	130,208	(7,860)	94
092	Arsimi I mesem	2,907	3,923		3,923	3,423	(500)	87
101	Semundje dhe paaftesi	168,161	182,200		171,195	171,146	(49)	100
104	Familja dhe femijet	6,524	8,080	7,095	13,064	5,940	(7,124)	45
105	Ndihma ekonomike	4,380	15,463		5,360	5,256	(104)	98
106	Strehim Social		1,440		1,440	1,260	(180)	88
	Ndihma ekonomike				-		-	
Totali i Shpenzimeve të Njesisë		722,262	985,289	159,172	734,828	632,768	(101,880)	86

Paraqitja grafike e realizimit totalit te shpenzimeve sipas programeve



Sic shihet nga aneksi nr 1 diferenca 101,880 mije leke tregon shumen e shpenzimeve te parealizuar per vitin 2019 dhe e shprehur ne % eshte 86 %. Peshen me te madhe ne totalin e mosrealizimit e zene investimet nga te ardhurat e bashkise sic eshte program 5200 ose Menaxhimit te Ujrave te Zeza realizuar si investim ne masen 21 % ose - 21,400 mije leke dhe nga keto vetem KUZ Sallmone kap shumen 19.000 mije leke , programi 6260 ose Sherbimet Publike Vendore ku futetobjekti Rehabilitimi I Hapesire Rekreative (Parku) ne shkollen Muharrem Dollaku per diference realizuar si investim ne masen 13 % ose -13.000 leke., programi 4240 ose Bujqesia ku kemi diferencen 5,971 mije leke fonde te ministrive te bujqesise dhe transportit te cilat nuk mund te perdoren nga ne, duke zene gati 6 % te fondit te mosrealizimeve, program 6440 ose Ndricimi duke zene 4% te mosrealizimit per Shumen 4,000 mije leke, nga mos realizimi I investimit per ndricimin e planifikuar ne unazen e vogel shijak, me objektivin per te bere nje investim te plote ne vitin pasardhes, program 1110 ose Organet ekzekutive dhe legjislative,ceshtjet financiare per diferencen 4,594 mije lekesh kemi

mos perdorim te fondit te celur per emergjenca ne Shumen 3,000 mije lekeve, diferenca eshte moslikujdime te faturave te ndryshme.

Jane perballuar me se miri shpenzimet per Energjine Elektrike fale nje pune te mire ne menaxhimin e ketij sektori jane shpenzuar 31,191 mije leke nga 40.000 te planifikuara per kete sherbim.

Gjithashtu sherbimet jetike per komunitetin sic jane: a) mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, b) mirëmbajtja dhe administrimi i sipërfaqeve të gjelberta, c) mirëmbajtja e varrezave publike d) furnizimin me ujë të pijshëm, e) mbledhja, largimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura, f) mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtja nga përmytjet në zonat e banuara, g) shërbimi i dekorit publik dhe ndriçimi i mjediseve publike, i) mirëmbajtja e rrugëve urbane dhe rurale si dhe realizimi sipas standarteve të sinjalistikës rrugore po realizohen ne nivel e te kenaqshme. Njëkohesisht cilesia e sherbimit te pastrimit eshte ne nivele relativisht te mira .

Bujqësia është një nga sektorët më të rëndësishëm ekonomik të Bashkisë, duke qene zone rurale. Jane kryer investime ne bujqesi si Rehabilitimi I e Kanali Ardhisht Rreth per Shumen 25.000 leke per vitin 2019 me fonde te buxhetit te shtetit

Gjate 2019 eshte synuar menaxhim me efikasitet i fondeve per Arsimin dhe krijimi i mundësive për zhvillim të institucioneve arsimore në të gjithë territorin e Bashkisë Shijak. Ka perfunduar ndertimi i Shkolles se re 9 vjecare “ Muharrem Dollaku “ne qytet brenda standarteve bashkohore. Ka filluar Ndertimi I Shkolles 9 vjecare Adem Sabli ne fshatin Borake te Nj.Ad Xhafzotaj me fonde te Buxhetit te shtetit dhe pjesemarrje te Bashkise per 10 % te fondit te ndertimit.Gjate gjithë vitit eshte ofruar sherbim mirembajtjeje per shkollat e te gjithë bashkise.

Krahas kesaj eshte zhvilluar aktivitet I rregullt ne qendren komunitare., ku gjate gjithë vitit aty trajnohen mesatarisht 12 femije me aftesi te kufizuara, ky aktivitet perballohet nga te ardhurat e bashkise sic jane shpenzimet e personelit prej 3 specialiste dhe 1 punonjes sherbime dhe qe kapin shumen 3.575 lekesh.

Ndersa per Komunitetin Rom, u jane siguruar ambjente me qera, te cilat paguhen nga Bashkia Shijak. Pjesa tjeter e cila trajtohet me ndihme ekonomike apo pagesa paaftesie eshte sherbyer ne maksimumin e mundshem, duke krijuar hapësira per te qene ndihme e nje numri sa me te madh te tyre.

Tabela e meposhteme Aneksi nr 3 liston investimet e realizuara ne vitin 2019.

Sic shihet ne total investimet jane realizuar ne masen 77 % dhe ne vlere leku kemi nje diference ne shumen minus 42,703 mije leke

Sic shihet investime te porealizuara jane

1.Rehabilitimi i Rruges Naim Frasheri investim i cili nuk u tenderua pasi ndodhi termeti i 26 nentorit dhe nuk u pa e arsyeshme te fillonte nje objekt i tille , ky fond eshte trasheguar ne buxhetin e vitit 2020 dhe me objektivin e mundshem per tu realizuar .

2.Investimi i Rehabilitimin e Hapesire Rekreative Parku i qytetit Shijak pa perfunduar punimet , edhe ky fond eshte trasheguar me te njejtin destinacion.

3.Ndertimi i KUZ Sallmone Nj.Ad Xhafzotaj pa perfunduar punimet , edhe ky fond eshte trasheguar me te njejtin destinacion.

4.Rindertimi i shkolles 9 vjecare Muharrem Dollaku i pa likujduar per shumen e punimeve e paperfunduara dhe fondi eshte trasheguar me te njejtin destinacion.

5.Rikualifikimi i Kuartalles ka perfunduar dhe diferencaeshte teprice fondi e cila i eshte bashkuar te ardhurave te trasheguara per vitin 2020


6.Ndertimi i KUZ Gjepalaj nje investim me fonde te buxhetit te shtetit, i paperdoruar per arsye te deshtimit te procedurave te prokurimit, per mungese marrje pjese ne tenderim te kontraktoreve te ndryshem.

BASHKIA SHIJAK**ANEKSI nr.3 "Projektet e investimeve me financim te brendshem dhe me financim te huaj"****Projektet me financim te brendshëm (ne 000/leke)****Viti 2019**

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë e projektit	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente,difer ne leke
1110	Persht e Ambj te Nj.Adm Xhafzotaj salle mb K.Bashkiak	6,802	6,802	6,802	100	-
1110	Mobilim I Zyrove te Bashkise Shijak	1,542	1,542	1,542	100	-
1110	Blerje paisje elektronike	750	750	694	93	56
1110	Shpronemim per objektin " Rehabilitim I Lagjes Lugina	1,828	1,828	1,705	93	123
1110	Shpronper objektin " Rrjeti Rrugor Shijak ish- Policia"	8,790	5,551	5,551	100	-
1110	Hartim Raporti I Ndikimit ne Mjedis	600	565	565	100	-
Dif faturash	FV kamerat e sigurise per Bashkise Shijak	935	247	247	100	-
Dif faturash	Blerje pajisje per magazinën dhe guzhina gatimi	120	36	36	100	-
4240	Hartezim e vleresim I Tokes bujqesore	912	912	912	100	-
4240	ZV I Portave metalike ne liqenin e Callikes	3,330	3,330	3,248	98	82
4520	Rikualifikim i Kuartalles	56,941	13,270	11,134	84	2,136
4520	Rehabilitim I Rrugeve te Naim Frasheri "Bashkia shijak	2,054	2,054	-	-	2,054
4520	Blerje makinerish per mirembajtjen e rrugeve	910	910	905		5
6260	Hapesire Rekreative Parku I Qytetit		20,000	7,000	35	13,000
6330	Riparim I rrjetit Ujesjelles Gjepalaj	1,080	630	630	100	-
4520	Zgara per mbledhjen e Ujrave sipërfaq ne Maminas	699	699	658	94	41
10430	Rrethimi I Cerdhes Maminas	804	804	804	100	-
FZH R	Rikonstruksion Rrjeti Rrugor Qyteti Shijak	99,367	6,006	6,006	100	-
FZH R	Rikon Rruges 8 Marsi dhe degzimet "Qyteti Shijak	19,621	7,962	7,962	100	-
FZH R	Rindertim i shkolles 9-Vjecare "Muharrem Dollaku"	78,584	42,647	42,647	100	-
FZH R	Rindertim i shkolles 9-Vjecare "Adem Sabli "			19,773	100	-

		71,982	19,773			
FZH R	Rehabilitim I Kanalit Ardhishte Rreth	64,324	25,000	25,000	100	-
FZH R	KUZ Gjepalaj	3,987	797	-	-	797
Ardh Bashkis	Rindertim i shkolles 9-Vjecare "Muharrem Dollaku"	6,000	6,000	591	10	5,409
Ardh Bashkis	KUZ Sallmone Nj.Ad Xhafzotaj	51,437	23,000	4,000	17	19,000
		483,399	191,115	148,412	77%	42,703

Paraqitja grafike e realizimit te Investimeve



Projektet me financim te huaj (ne 000/leke)

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Buxheti Kontraktuar	Plani i buxhetit viti	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	Komente
	Ndertim e Ambulance te re ne fshatin Xhafzotaj.Ad Xhafzotaj.	17,728			

Ky Investim është realizuar me mbështetjen e Qeverisë Zviceriane nëpërmjet e Projektit “Programi i Zhvillimit Rajonal për Shqipërinë”.

Programi 011 Organet ekzekutive dhe legjislative, Ceshtjet financiare është realizuar në masën 95 % ose - 4594 mijë leke dhe këtu vetëm mosrealizimi i investimeve që siç e përmendëm më sipër shuma 3000 leke emergjence civile e pa përdorur , kemi 1594 mijë leke shpenzime operative të përealizuara siç janë fatura të ndryshme të cilat janë planifikuar për pagesë në vitin 2020 me të ardhurat të trashëguara.

Programi 045 Rrjeti Rrugor kemi mos realizim 86 % ose 7,054 mijë leke për dy objektet Rehabilitimi isheshit Naim Frasheri tenderi i anuluar, dhe Rehabilitimi i Rrugës Lagje Kokomaneve me fonde të buxhetit të shtetit tëpricë nga tenderimi.

Programi 042 Bujqësia, pyjet, peshkimi dhe gjuetia është realizuar 89 % ose në vlerë - 6430 mijë leke, këtu kemi 2076 mijë leke tëpricë nga fondet e Kanaleve Ujitesë dhe Kulluesë, mosrealizimi i investimit për studimin dhe ndarjen e tokës bujqësore .

Programi 051 Menaxhimi i mbetjeve është realizuar 80 % ose -10,884 mijë leke kjo është nga moslikujdimi i faturave të pastrimit nga mungesa e të ardhurave.

Programi 062 Shërbimet publike ,realizuar në masën 41 % ose 19,536 mijë leke që po të zbrësim investimin e palikujduar që e përmendëm më sipër që është 13 ,000 leke, kemi shumën 2,000 mijë leke detajuar nga fondi rezerve edhe ky i përdorur, diferenca janë fatura për shpenzime operative të përealizuara si dhe nga mos likujdimi i tyre nga mos realizimi i të ardhurave .

Programi 063 Furnizimi me Ujë realizuar në masën 81 % ose - 400 shpenzime operative të pakryera.

Programi 081 Shërbimet Rekreative dhe sportive realizuar në masën 82 % ose -5,985 mijë leke janë honorare e sportit të padhëna për mungesë të ardhurash..

Programi 091 Arsimi baze dhe parashkollor është realizuar 94 % , ose 7860 mijë leke ku 5,409 mijë leke janë investimi i pambyllur në objektin Rindertimi i shkollës Muharrem Dollaku , ndërsa në këtë program janë realizuar shpenzimet baze me të domosdoshme , si energji, ujë, dru zjarri gaz për ngrohje të mirëmbajtje të ndryshme ,diferenca prej 4,623 mijë lekesh janë fatura të likujduara dhe shpenzime të përealizuara .

Auditimi I veprimtarise financiare te Bashkise Shijak

Gjate vitit 2019 Bashkia Shijak nuk ka patur auditime nga autoriteti i KLSH apo nga auditu i brendshem, por ka vazhduar puna per realizimin e detyrave te lena nga audituesit e KLSH nga viti 2018.

DETYRIMET E PRAPAMBETURA NGA VITI 2019

Tabela nr. 1: Zhvillimi i shumës së detyrimeve të prapambetura deri në tremujorin _Janar - Dhjetor 2019

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	(1) (Detyrimi i mbartur deri në 31.12.2015)	(3) Detyrim i krijuar Viti 2017	(9=1+2+3+4+5+6+7+8) Totali i detyrimeve te krijuara	(10) Detyrimet e prapambetur a të shlyera (viti 2015, 2016, 2017)	(16=10+11+12+13+14+15) Totali i detyrimeve te shlyera	(18=9-16) Detyrimi i mbetur
Vlera Totale	2,491,481		60,901,856		26,974,117	33,927,739
Investimet			20,379,960		11,000,000	9,379,960
TVSH dhe Kosto lokale			0		0	0
Mallra dhe Shërbime			34,134,147		15,175,836	18,958,311
Vendime Gjyqësore	2,491,481		6,387,749		798,281	5,589,468
Të tjera			0		0	0

Tabela nr. 2: Raporti përmbledhës për detyrimet e mbetura nga Investimet financuar nga FZHR për tremujorin Janar-Dhjetor 2019

Emertimi i projektit	Ministria e Linjes	Viti I financimit te projektit	Vlera e financuar ne vitin 2019	Detyrimi i mbetur per financim
Ndertimi i Shkolles 9-vjecare Rreth				526,247
Sistem asfalt Rruga 8-Marsi Shijak			7,942,144	
Rindertimi I Shkolles Muharrem Dollaku			42,646,568	35,937,785
Rindertimi I Shkolles Adem Sabli			19,772,460	52,210,048
Rehabilitimi I Kanalit Ardhishte - Rreth			25,000,000	37,147,492
Vlera Totale				125,821,572

Tabela nr. 3: Raporti përmbledhës për detyrimet e prapambetura te SHLYERA (per detyrimet e prapambetura deri ne vitin 2015)

Detyrimet e nj.v.q.v (lekë)	Detyrimet e shlyera per detyrimet e prapambetura deri në 31.12.2015)
Vlera Totale	91,812,783
Investimet	
Investimet nga FZHR	91,014,502
TVSH dhe Kosto lokale	
Mallra dhe Shërbime	0
Vendime Gjyqësore	798,281
Të tjera	

Pasqyra Financiare e vitit 2019

Keto jane formularet nr 1,2 te Bilancit te Bashkise Shijak per vitin 2019 ku pasqyrohen aktivet dhe pasivet e tij.

Nr. Resht i	Referenca e Logarive	EMERTIMI	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	A	AKTIVET	2,720,572,954	2,931,579,860
2		I.Aktivët Afat shkurtër	301,133,131	260,691,188
3		1.Mjete monetare dhe ekuivalent të tyre	100,051,674	90,594,303
4	531	Mjete monetare në Arke		
5	512,56	Mjete monetare në Banke		
6	520	Disponibilitete në Thesar	97,694,229	87,357,058
7	50	Letra me vlerë		
8	532	Vlera të tjera	2,357,445	3,237,245
9	54	Akreditiva dhe paradhënie		
10	59	Provizione zhvlersimi letra me vlerë (-)		
11		2.Gjendje Inventari qarkullues	62,066,191	61,537,438
12	31	Materiale	6,833,258	8,301,027
13	32	Inventar i imet	55,232,933	53,236,411
14	33	Prodhim në proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe në rritje e majmeri		
18	37	Gjendje të pa mbitura, ose pranë të treta		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provizione për zhvlersimin e inventarit (-)		
21		3.Llogari të Arketushme	110,186,260	99,878,591
22	411	Kliente e llogari të ngjashme		
23	423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore që mbulohe në shteti		
27	435	Sigurime Shoqërore		
28	436	Sigurime Shëndetsore		
29	437,438,	Organizma të tjera shtetërore		
30	44	Institucione të tjera publike		
31	465	Efekte për të arketuar nga shitja e letrave me vlerë		
32	468	Debitorë të ndryshëm	96,402,332	85,959,524
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	13,783,928	13,919,067
34	45	Mardhënie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma të parashikuara për zhvlersim (-)		
36		4.Te tjera aktive afatshkurtra	28,829,006	8,680,856
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes të mardhënieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime		
41	486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	28,829,006	8,680,856

42		II.Aktivët Afat gjata	2,419,439,823	2,670,888,672
43	20	1.Aktive Afatgjata jo materiale	61,651,348	60,175,348
44	201	Prime të emisionit dhe Rimbursimit të huave		
45	202	Studime dhe kërkime	61,651,348	60,175,348
46	203	Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme		
47	21	2.Aktive Afatgjata materiale	2,338,840,448	2,591,765,297
48	210	Toka, T, roje, Terene	24,685,005	24,685,005
49	211	Pyje, Plantacione	4,830,000	4,830,000
50	212	Ndertesa e Konstruksione	552,508,201	638,249,640
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,688,174,208	1,814,000,360
52	214	Instalime teknike, makineri e paisje	21,879,867	36,837,199
53	215	Mjete Transporti	28,402,424	43,996,188
54	216	Rezerva Shtetërore	0	
55	217	Kafshe pune e prodhimi	0	
56	218	Inventar ekonomik	18,360,743	29,166,905
57	24	Aktive afatgjata të demtuara		
58	28	Caktime të Aktiveve Afatgjata		
59	25-26	3.Aktive Afatgjata Financiare	0	0
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet		
62		4.Investime	18,948,027	18,948,027
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale	18,948,027	18,948,027
65	B	PASIVET(DETYRIMET)	154,273,349	131,218,573
66		I.Pasivet Afat shkurtra	154,273,349	131,218,573
67		1. Llogari të Pagushme	154,273,349	131,218,573
68	401-408	Furnitore e llogari të lidhura me to	2,693,115	5,178,800
69	42	Detyrime ndaj personelit	9,972,445	9,957,000
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhenes		
72	431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	481,798	622,809
73	432	Tatime, mbledhur për llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqesi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	3,329,685	3,339,258
76	436	Sigurime Shëndetsore		
77	437,438,	Organizma të tjera shtetërore		
78	44	Institucione të tjera publike		
79	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditorë për mjete në ruajtje	13,429,395	17,066,398
82	467	Kreditorë të ndryshëm	55,811,719	12,180,101
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	68,555,192	82,874,207
84	49	Shuma të parashikuara për xhvlësim(-)		
85		2.Të tjera pasive afatshkurtra	0	0
86	419	Kreditorë, Parapagime		

87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhese		
88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arketuara para nxjerrjes se titullit		
91		II.Pasivet Afat Gjata	0	0
92	Klase 4	Llogari te pagushme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigionet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	C	AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)	2,566,299,605	2,800,361,287
97	D	FONDI I KONSOLIDUAR :	2,566,299,605	2,800,361,287
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	1,784,499,821	2,133,921,481
99	12	Rezultatet e mbartura		0
100	85	Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore	84,264,834	70,290,660
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	697,534,950	596,149,146
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjewteve te caktuara ne perdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlersimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	E	TOTALI I PASIVEVE(B+C)	2,720,572,954	2,931,579,860
KONTROLLE				
		Shifra 0(Zero)- Tregon Kuadraturen	Kuadratura	Kuadratura
Kontroll 1.		Aktivet Neto a jane te barabarta me Fondin e Konsoliduar	0	0
Kontroll 2.		Totali I Aktiveve a eshte i barabarte me = Totalin e Pasiveve	0	0

Sic shihet nga bilanci Bashkia Shijak per vitin 2019 rezulton me 84,264,834 leke gjendje ne llogarine e thesari si celje per vitin 2020. Kjo shume tashme eshte detajuar ne Vendimin e Keshillit Bashkiak Nr 12 date 25.02.2020 me objekt "Per shtese Buxheti per vitin 2020.

Drejtori Ekonomik

Pranvera Alushi